



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:273444
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05465371

C – IV. – 15 – 0831

Paditësi:

U U nga fshati K i Komunës së Istogut.

Kundër

E paditura:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i pagave të pa paguara.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **18.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, U U nga fshati K i Komunës së Istogut e parashtruar kundër të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe lidhur me Vendimin, PEJ194-0001 dt.26.03.2015, dhe Vendimit të korrigjuar, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015 të të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë – Autoriteti i Likuidimit (AL) dhe Vendimi, PEJ194-0001 dt.26.03.2015, dhe Vendimi i korrigjuar, PEJ194-0001 dt.28.04.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "Enti për Medicinë Fizikale dhe Rehabilituese Banjë" me seli në Istog (në likuidim), **VËRTETOHEN, si të drejta dhe të bazuara në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësi, me dt.21.05.2015, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), ka paraqitur ankesë - kërkesë për rishikim të Vendimit, PEJ194-0001

dt.26.03.2015, dhe Vendimit të korigjuar, PEJ194-0001 dt.28.04.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për shkak të refuzimit të kërkesës për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë të përgjithshme prej 11.228.95 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), “Enti për Medicinë Fizikale dhe Rehabilituese Banjë” me seli në Istog (në likuidim).

Paditësi parashtrësën e drejtuar pranë DhPGJSK-së, e ka titulluar si “*ankesë - kërkesë*” mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në ankesën e parashtruar thekson se vendimi i kundërshtuar është i përfshirë në shkelje të natyrës formale dhe materialo – juridike, ku shkeljeve formale i referohet kundërthëniet të cilat shfaqen në arsyetimin e vendimit dhe i cili është në kundërshtim me dispozitivin ndërsa shkeljet materiale, pasi nuk qëndron arsyetimi sa i përket parashkrimit referuar nenit 379.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe se në rastin konkret nuk mund të bëhet për parashkrim të ekzekutimit të kërkesës sipas aktgjykimit C.nr.160/97 pasi që në vitin 1997 ka parashtruar propozim për ekzekutimin e këtij aktgjykimi në Gjykatën Komunale në Istog, e për të cilën në momentin kur ka paraqitur propozimin për ekzekutim, e paditura ka pranuar kthimin e paditësit në punë dhe pas disa ditësh e ka larguar përsëri, ndërsa pjesa tjetër e vendimit lidhur me pagat ka mbetur në procedurë të ekzekutimit dhe nga ana e gjykatës kjo procedurë nuk është përfunduar, dhe se lënda kur gjendet në gjykatë ndërprehet afati i parashkrimit, dhe se afatin 10 vjeçar i parashkrimit sipas nenit 379.1 të LMD i referohet fillimit të procedurës, dhe se në këtë rast nuk vlen meqë procedura është filluar në vitin 1997, dhe se vazhdimisht ka kërkuara kompensimin nga ndërmarrja por pagesa nuk është bërë, me propozim që vendimi i atakuar të ndryshohet duke pranuar kërkesën për kompensim.

Paditësi kësaj ankesë, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse: Vendimin, PEJ194-0001 dt.26.03.2015 të AL dhe vendimin për korigjim, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015, shkresën e AKP dt. 06.01.2015, aktgjykimin C.nr.18/93 dt. 05.10.1995, të Gjykatës Komunale Istog, aktgjykimin, Ac.nr.246/96 dt. 25.06.1996, të Gjykatës së Qarkut Pejë, aktgjykimin, REV.6037/96 të dt.04.02.1997 të Gjykatës Supreme në Beograd, aktgjykimin, C.nr.160/79 të dt. 04.11.1997 të Gjykatës Komunale në Istog, ekspertizën financiare të dt.20.11.2013 të ekspertit financiar, R B, kërkesën e paditësit të adresuar AL-së dt.19.01.2015, shkresën adresuar AKP-së dhe ankesën e dt.22.04.2015 të adresuar AKP-së.

Me dt.03.04.2023, e paditura, ka parashtruar mbrojtje ndaj ankesës së paditësit të parashtruar kundër Vendimit të AL-së, PEJ194-0001 dt.26.03.2015, duke kundërshtuar se ankesa është e papranueshme dhe e pabazuar, duke theksuar rregullin bazik të procedurës kontestimore sipas të cilit se pala kërkuese (parashtruesi) ka detyrimin e barrës së provës (neni 7 i LPK dhe neni 23 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033), si rregull e caktuar me nenin 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034, duke theksuar se Autoriteti i Likuidimit drejtë e vlerësoi në vendimin e tij, se kërkesa e parashtruesit për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën 16.11.1992-05.08.1997 në shumë prej 11.228.95 €, në bazë të aktgjykimit, C.nr.169/97 dt. 01.11.1997, ishte parashkruar në përputhje me nenin 379 të LMD-së, dhe se Aktgjykimi, C.nr.169/97 dt.04.11.1997, i formës së prerë më 24.11.1997, e obligon NSH që ta kompensoj parashtruesin në emër të ardhurat personale për periudhën 16.11.1992-16.08.1997 në shumën prej 46.282 dinarë, se neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për AKP, parashikon se: “*Elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore*

të aplikueshme”, dhe nenit 37.4.1 të kësaj Shtojce që parashikon se “kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi”, referuar nenit 379 të LMD (1978), që përcakton afatin 10 vjeçar të parashkrimit. Më tej shton se padia për kompensim e të ardhurave personale si pasojë e anulimit të vendimit për largim nga puna, ka rezultuar me aktgjykim të formës së prerë, C.nr.169/97, i plotfuqishëm më 24.11.1997, për të cilën parashtruesi ka pasur kohë 10 vite për të kërkuar ekzekutimin e tij dhe të sigurohej që i njëjti të mos parashkruhej, mirëpo edhe pas kërkesës së AL-ja për dëshmi dhe informacion shtesë, me të cilën kërkohej që të paraqiste dëshmi se ka ndërmarrë ndonjë veprim për ekzekutimin e aktgjykimit në fjalë, brenda afateve ligjore parashtruesi nuk dorëzoi asnjë provë që do të vërtetonte një gjë të tillë, deri më dt.19.12.2013, kur dorëzoi kërkesën kreditore pranë AL-së, duke konsideruar parashtruesi se ka ndërprerë parashkrimin e aktgjykimit me kërkesën për ekzekutim të aktgjykimit, por kundër pretendimeve deklarative nuk ka paraqitur para AL-së e as tani në shkresat e kësaj ankese ndonjë dëshmi / dokument që vërteton realisht se ka dorëzuar propozimin për ekzekutim, andaj edhe argumenti për ndërprerjen e parashkrimit rezulton plotësisht i pabazuar, dhe i paraqet gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe ta vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe se kësaj Mbrojtje, ia ka bashkangjitur kopjen e kërkesës së AKP-së të dt.06.01.2015 të dërguar në adresë të paditësit për sigurimin e informacionit shtesë dhe dëshmitë në mbështetje të ankesës/padisë së tij si dhe kopjen e kërkesës së AKP-së për emërimin e anëtarëve të AL-së për NSh, “Enti për Medicinë Fizikale dhe Rehabilituese Banjë” me seli në Istog (në likuidim) .

Me dt.06.12.2016, paditësi, ka parashtruar përgjigje në mbrojtjen e të paditurit, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e të paditurës si të pabazuara e veçmas atë rreth parashkrimit të kërkesës duke konsideruar se para AL-së, ka deponuar dokumnetacionin përkatës kopje aktgjykimit, C.nr.18/93 dhe 169/97, librezën e punës, letërthirrjen, një ekspertizë në gjuhën serbe dhe një ekspertizë të ekspertit, R B përmes parashtruesës dt.19.01.2015, dhe se kësaj Përgjigjeje, ia ka bashkangjitur kërkesën e tij të dt.19.01.2015 të dërguar tek AL-ja, si dhe kopjen e kërkesës së AKP-së të dt.06.01.2015 të dërguar në adresë të paditësit për sigurimin e informacionit shtesë dhe dëshmitë në mbështetje të ankesës/padisë së tij

Me dt.27.12.2016, e paditura, ka paraqitur Kundërpërgjigje në Përgjigjen e paditësit e në të cilën ka theksuar se kundërshton si ekzistencën ashtu dhe lartësinë e detyrimit të pretenduar duke përsëritur qëndrimet e paraqitura në mbrojtje e më gjerësisht si në këtë Kundërpërgjigjeje.

Me dt.19.10.2016, paditësi, i është drejtuar DhPGJSK-së me urgjencës për procedimit të kësaj lënde.

Me dt.29.02.2024, DhPGJSK-ja, me aktvendimin e saj, C- IV.- 15 – 0831 të dt.29.02.2024, ka urdhëruar paditësin që në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, që të bëjë plotësimin e padisë së tij të paraqitur pranë DhPGJSK-së me dt.21.05.2015 dhe atë kundër të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e që ka të bëjë me Vendimin e AL-së, PEJ194 - 0001 të dt.23.03.2015 dhe i korrigjuar me Vendimin e AL-së, PEJ194 - 0001 të dt.28.04.2015 për shkak të kompensimit të pagave të pa paguara e në shumën prej 11.228,95 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), “Enti për Medicinë Fizikale dhe Rehabilituese Banjë” me seli në Istog (në likuidim), në atë mënyrë që për gjykatën, të siguroj të dhënat se aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.167/97 i dt.04.11.1997, a është bërë i formës së prerë e nëse është i tillë të siguroj provën se paditësi, ka bërë propozim për përmbarrim pranë gjykatës kompetente si dhe provat tjera në mbështetje të padisë së tij e nën pasojnë gjejtëse në rast të mos veprimit sipas këtij aktvendimi.

Me dt.14.03.2024, paditësi, i është drejtuar kësaj gjykate dhe i është përgjigjur Urdhrit të lartëcekur të saj, dhe se kësaj Përgjigje,ia ka bashkangjitur aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.167/97 i dt.04.11.1997 dhe i cilin aktgjykim, është i pajisur me vulën e plotëfuqishmërisë dhe atë kjo vulë e mban datën 26.11.1997 dhe kopjen e Urdhëresës, C.nr.169/97 të dt.11.-09.1997 të Gjykatës Komunale në Pejë për caktimin e ekspertizës.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Ligji i Dhomës së Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 398 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund t'a nxjerr aktgjykimin.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, duhet të refuzohet si e pabazuar:

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata gjen se paditësi në procedurë të likuidimit të Ndërmarrja “Enti për Medicinë Fizikale dhe Rehabilituese Banjë” me seli në Istog (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit dt.09.12.2013, dhe se me ankuesi me dt.19.12.2013, ka parashtruar kërkesën për kompensim për paga të papaguara në shumë të përgjithshme prej 11.228.95 €, e cila kërkesë është refuzuar me Vendimin e AL-së, PEJ194-0001 dt.26.03.2015 dhe Vendimin, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015 (i korrigjuar) derisa kërkesa/padia e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga neni në kuptim të nenit 36 lidhur me nenin 33 dhe 35 dhe 74 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe nenit 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në) sepse paditësi ka parashtruar ankesën - kërkesën për shikimin e vendimit - padinë e ushtruar kundër këtij vendimi, pranë Dhomës së Posaçme, me dt.21.05.2015, pra brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të Vendimit të korrigjuar të AL-së, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015 për ushtrimin e saj pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe se kësaj kërkesë, i ka bashkangjitur edhe Vendimet e kundërshtuara të Autoritetit të Likuidimit (AL), PEJ194-0001 dt.26.03.2015 dhe Vendimin, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015, dhe provat tjera të theksuar më lartë.

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese në mesë të palëve ndërgjyqëse, pra paditësit dhe të paditurës, Ndërmarrja Shoqërore, (NSH), “Enti për Medicinë Fizikale dhe Rehabilituese Banjë” me seli në Istog (në likuidim), ka ekzistuar raporti juridik i marrëdhënies së punës, dhe se nuk është kontestuese se paditësi ka kërkuar që nga NSH-ja, të realizoj kompensim për paga të papaguara në shumë të përgjithshme prej 11.228.95 €, e cila kërkesë është refuzuar si e pavlefshme me Vendimin e AL-së, PEJ194-0001 dt.26.03.2015 dhe Vendimin, PEJ194-0010 të dt.28.04.2015 por kontestues na paraqitet fakti se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara, a është bërë brenda afateve ligjore të parapara me ligjin në fuqi apo jo.

Gjykata gjen se Vendimi i AL-së, PEJ194-0001 i dt.26.03.2015 dhe i korigjuar me Vendimin, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015 e me të cilën, është refuzuar kërkesa e palës paditëse, përmban faktin se AL-ja, kishte vlerësuar kërkesën e paditësit e duke refuzuar si të pabazuar dhe të parashkruar në arsyet si më poshtë konform nenit 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP, dhe nenit 379 par. 1 të LMD-së, se AL-ja, ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se *“elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*, dhe nga neni 379.1 të LMD), që përcakton afatin 10 vjeçar të parashkrimit e më tej ka shtuar se padia për kompensim të të ardhura personale si pasojë e anulimit të vendimit për largim nga puna, ka rezultuar me aktgjykim të formës së prerë C.nr.169/97 të dt.04.11.1997, dhe i plotfuqishëm më 26.11.1997 deri më dt.19.12.2013, kur parashtruesi dorëzoi kërkesën kreditore pranë AL-së, duke konsideruar se ka ndërprerë parashkrimin e aktgjykimit me kërkesën për ekzekutim të aktgjykimit.

Gjykata, ka shqyrtuar edhe pretendimet dhe provat tjera të paraqitur nga palët ndërgjyqëse, me të cilat shkresa vërtetohet se paditësi lidhur me objektin kontestues vazhdimisht ka qenë në procedurë të kërkesës në realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, e të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga autoritete kompetente të ndërmarrjes, e kundër të cilit vendim kishte shfrytëzuar të drejtat gjyqësore në realizimin e saj, dhe kjo dëshmohet me aktgjykimet. C.nr.18/93 e dt.05.10.1995 të Gjykatës Komunale në Istog, aktgjykimin, Ac.nr.246/96 të dt.25.06.1996 të Gjykatës së Qarkut Pejë, aktgjykimin, REV.nr.6037/96 të dt.04.02.1997 të Gjykatës Supreme në Beograd, dhe aktgjykimin, C.nr.169/79 të dt.04.11.1997 të Gjykatës Komunale në Istog, duke iu adresuar AKP-së për kompensimin e pagave të pa paguara, për të cilën AL-ja i AKP-së, me shkresën e dt. 06.01.2015, kishte kërkuar informacion dhe dëshmi mbështetëse, e për të cilën me shkresën e dt. 19.01.2015, parashtruesi i është përgjigjur duke bashkangjitur dokumentacionin përkatës, kopjen e aktgjykimeve, C.nr.18/93 dhe C.nr.169/97 të Gjykatës Komunale në Istog, librezën e punës, letërthirrjen, një ekspertizë të vjetër në gjuhën serbe dhe një ekspertizë të ekspertit Blakaj, që konstatohet se pretendimet e palës paditëse janë paraqitur me kohë tek e paditura në procedurën e likudimit por jo edhe pranë gjykatës në procedurën gjegjëse gjyqësore për realizimin e aktgjykimit të plotëfuqishëm, C.nr.167/97 e dt.04.11.1997 të Gjykatës Komunale në Istog, pra në procedurën e përmbarrimit.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të AKP-së, aty thuhet se: *“Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2”* .

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara për pagat e parapara në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) e në të cilin, parashihet se : *“Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”* .

Në bazë të nenit 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *“... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”* derisa në bazë të 379 par.1 të Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare, RSFJ nr.29/78, i cili parasheh se: *“Të gjitha*

kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me anë të pajtimit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet ...“ derisa dispozitë të ngjashme, rreth parashkrimit 10 vjeçar të një kërkesë monetare, parasheh edhe neni 361 par.1 i Ligjit, Nr.04/L-077 i dt.10 maj 2012 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) të Republikës së Kosovës, e në të cilin, parashihet se : ”Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim ...”.

Gjykata vëren se në rastin konkret kërkesa e parashtruar, është jashtë afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara në shumë të përgjithshme prej 11.228.95 € nga Ndërmarrja Shoqërore, NSH, ”Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve” me seli në Pejë (në Likuidim), si palë e paditur pasi që Ndërmarrja Shoqërore (NSH), “Enti për Medicin Fizikale dhe Rehabilituese Bajë” me seli në Istog (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit dt.09.12.2013, dhe se kjo kohë ka qenë e përcaktuar për parashtrimin e të drejtave pas themelimit të AKM –së e tani AKP-së, dhe se paditësi të drejtën e pretenduar për kompensim me të drejtë ka parashtruar kërkesën në procedurë të likuidimit me dt.19.12.2013 dhe atë pranë Autoritetit të Likuidimit dhe i cili ka qenë autoriteti kompetent për shqyrtuar kërkesën e paditësit në procedurë të likuidimit por që kërkesa e tij është refuzuar si e pa vlefshme dhe se me këtë qëndrim të shprehur të AL-së në Vendimet e kontestuara të tij, pra me Vendimin, PEJ194-0001 dt.26.03.2015, dhe me Vendimin e korigjuar, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015, edhe kjo gjykatë, e ka marrë si të drejtë pasi dispozitat nga neni 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 të AKP dhe lidhur me parashkrimin sipas dispozitave nga neni nga neni 379 par.1 të LMD-së, që përcakton afatin 10 vjeçar të parashkrimit, e meqë në rastin konkret, kemi të bëjmë me kërkesa monetare, këto dispozita ligjore e veçmas neni 379 par.1 i LMD-së, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78 gjegjësisht neni 361 i LMD-së, Nr.04/L-077 i dt.10 maj 2012, gjejnë zbatim në këtë çështje juridike kontestimore e veçmas edhe për shkak të faktit se paditësi, nuk ka arritur që të bind gjykatën se ka iniciuar procedurën gjyqësore e në funksion të realizimit të aktgjykimit të plotëfuqishëm, C.nr.169/79 dt. 04.11.1997, të Gjykatës Komunale në Istog. Pra po që se shikohet data e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e cila e mban dt.26.11.1997 dhe bërjes së kërkesës në procedurën e likuidimit, me dt.19.12.2013, shihet se ka kaluar 10 (dhjetë) vjet nga dita e të bërit të plotëfuqishëm të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Istog, C.nr.169/79 të dt. 04.11.1997, dhe se afati i fundit për t'a bërë këtë kërkesë, ka qenë dt.26.11.2007 derisa nuk ka prova se para kësaj date, pra se paditësi, t'i ishte drejtuar ndonjë gjykate për realizimin e këtij aktgjykimi në procedurën e përmbarrimit.

Vlerësimet përfundimtare të gjykatës.

Gjykata pasi që ka administruar prova gjegjëse që gjendjen në shkresat e lëndës, pas konstatimit të gjendjes faktike, ka ardhur në përfundimin se qëndrimi i të paditurës për refuzimin në tërësi si të pa vlefshme të kërkesës së paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën e pretenduar, dhe atë shprehur përmes Vendimit të AL-së, PEJ194-0001 dt.26.03.2015, dhe me Vendimin e korigjuar, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015, për NSH “Enti për Medicinë Fizikale dhe Rehabilituese Bajë” me seli në Istog (në likuidim) për parashkrimin e kërkesës së paditësit, është i drejtë, dhe se AL-ja, ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, kur është bazuar në nenin 36 par.2 pika 2 të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në si dhe në nenin 379.1 të LMD (1978), përkatësisht neni 361 i LMD-së, Nr.04/L-077 i dt.10 maj 2012, e nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se paditësi edhe pse përmes aktgjykimit, C.nr.169/79 dt. 04.11.1997 të Gjykatës Komunale në Istog, i është

njohur kjo e drejtë, me mos të provuarit të faktit se para dt.19.11.2013, paditësi të ketë kërkuar realizimin e këtij aktgjykimi e që të konsiderohej se paditësi e ka ruajtur vazhdimësinë e kërkesës së parashtruar në realizimin e saj në shumën e pretenduar prej 11.228.95 €, andaj me arsytet e cekura më lartë, kërkesëpadia e paditësit, U U nga fshati K i Komunës së Istogut për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë të përgjithshme prej 11.228.95 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “Enti për Medicinë Fizikale dhe Rehabilituese Banjë” me seli në Istog (në likuidim), është e pabazuar dhe Vendimi, PEJ194-0001 dt.26.03.2015, dhe Vendimin i korrigjuar, PEJ194-0001 të dt.28.04.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL), duhet të vërtetohen si të drejta dhe të bazuar në ligj.

Prandaj nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në kuptim të nenit 9, 54 par.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr.06/L- 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:273444, 18.03.2024

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.